



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I MINISTRAVE  
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT

V E N D I M

Nr. 08, datë 12.12.2017

P Ë R

MIRATIMIN E LEJES SË NDËRTIMIT PËR OBJEKTIN: “ZGJERIMI I RRJETIT TË  
KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE TË OPERATORIT “TELEKOM ALBANIA”  
NËPËRMJET SHTIMIT TË ANTENAVE PËR 5 STACIONE BAZË”

Në mbështetje të neneve 27 dhe 28 të Ligjit Nr. 107/2014, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar, Vendimit Nr. 408, datë 13.05.2015 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar, si dhe Vendimit Nr.519, datë 20.09.2017 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit”, me propozim të shoqërisë “Telekom Albania” sh.a, Këshilli Kombëtar i Territorit,


V E N D O S I:

1. Miratimin me kusht të Lejes së Ndërtimit për objektin: “Zgjerimi i rrjetit të komunikimeve elektronike të operatorit “Telekom Albania” nëpërmjet shtimit të antenave për 5 stacione bazë”, me subjekt zhvillues shoqërinë “Telekom Albania” sh.a.
2. Harta e Planvendosjes së Strukturave bashkëlidhet si pjesë përbërëse e këtij vendimi.
3. Dokumentet i Lejes së Ndërtimit i jepen subjektit zhvillues veçmas për secilin prej 5 stacioneve bazë, vetëm pas plotësimit të kushteve të poshtëshënuara:
  - a. Për stacionin “**Campus New 0207**”:
    - regjistrimit të Lejes së Legalizimit pranë ZVRPP;
    - pagesës së taksës së ndikimit në infrastrukturë për llogari të Bashkisë Tiranë.
  - b. Për stacionin “**Kombinati Center 0199**”:
    - regjistrimit të Lejes së Legalizimit pranë ZVRPP;
    - pagesës së taksës së ndikimit në infrastrukturë për llogari të Bashkisë Tiranë.
  - c. Për stacionin “**Vojnik 1601**”:
    - pagesës së taksës së ndikimit në infrastrukturë për llogari të Bashkisë Dibër.

- d. Për stacionin “**Valbona 1560**”:
- pagesës së taksës së ndikimit në infrastrukturë për llogari të Bashkisë Tropojë.
- e. Për stacionin “**Gjirokastra New 1559**”:
- pagesës së taksës së ndikimit në infrastrukturë për llogari të Bashkisë Gjirokastrë.
4. Ngarkohet Agjencia e Zhvillimit të Territorit në bashkëpunim me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, për zbatimin e këtij vendimi.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARI**

**EDI RAMA**



MINISTËR I LINJËS  
MINISTËR I INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË  
DAMIAN GJIKNURI



ANËTAR / SEKRETAR I KKT  
DREJTOR I AGJENCISË SË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT



LEDIA TOTA